

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

ELKRI COMIMPEKS SHPK

ORTAKET

Sot me daten 01 shkurt 2006 , ne Sarande , une e quajtura Fotina Rondo , e bija e Lefterit , e datelindjes 11.11.1958 , lindur ne Himare-Vlore dhe banuese ne Lagjen Nr.4 Sarande , me deshiren dhe vullnetin tim te plote vendosa qe te themeloj Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin **ELKRI COMIMPEKS SHPK** , si Ortak i Vetem.

QELLIMI

Neni 1

Qellimi i ketij Akt-Themelimi eshte krijimi i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **ELKRI COMIMPEKS SHPK** , me seli ne Lagjen Nr.4 te Qytetit te Sarandes.

Qendra e shoqerise aktualisht do te jete ne adresen e sipershenuar por me kalimin e kohes mund te ndryshoje seline e saj.

Objekti i shoqerise eshte:

- import eksport i pergjithshem ;
- tregeti me shumeice dhe pakice i te gjitha llojeve te prodhimeve , artikujve industriale , ushqimore , veshmbathje , bujqesore , blegtorale , te peshkimit detar e lumor , te materialeve te nderlidhjes , te llokacionit , te prodhimeve te ndertimit ;
- turizem ;
- shitblerje me ~~pakice~~ pakice te karburanteve dhe lubrifikanteve;
- te shitblerjes se trojeve dhe objekteve te ndertimit ;
- te veprimeve e transaksioneve financiare , zyres komisionere dhe veprime te tjera financiare me qellim biznesi .

Kete aktivitet do ta ushtroje aktualisht si ortak dhe administrator i vetem. Me kalimin e kohes administratori mund te nderrohet me pelqimin e ortakut te vetem.

DATA EFEKTIVE

Neni 2

Ky akt themelimi do te jete efektiv qe nga momenti qe do te neneshkruhet nga ortaku i vetem statute,kerkesa dhe te jene plotesuar te gjitha procedurat ligjore,te jete bere regjistrimi ne Gjykatën e Rrethit Tirane dhe te kete fituar zotesi juridike per te vepruar si person juridik.

KAPITALI

Neni 3

Kapitali fillestar i shoqerise do te jete 100.000 leke.Ky kapital eshte i depozituar ne nje nga bankat e ~~Sarandes~~ . Kapitali eshte vendosur 100% nga ortaku i vetem Fotina Rondo.Ai eshte ndare ne 100 aksione me vlere 1.000 leke secili.

AFATI

Neni 4

Kjo shoqeri do te jete me nje kohezgjatje prej 35 (tridhjetepese) vjet.





JURIDIKSIONI

Neni 5

Kete akt themelimi e mbeshtes ne ligjet Nr.7512 dt.10.08.1991 dhe Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare",dhe mbasi te regjistrohem si person juridik i kesaj shoqerie ne Gjykatën e Tiranës dhe Zyren Tatimore,do te zhvilloje veprimtarine private sipas objektit te shenuar ne statut dhe te percaktuar ne vendimin perkates te Gjykeses si person juridik.

Ne aktivitetin tim ne kete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar do ti permbahem statutit te hartuar per kete qellim dhe do te respektoje dispozitat ligjore ne fuqi ashtu edhe ato qe do te dalin me vone per veprimtarine private te shoqerive prodhuese e tregetare.

Ky akt themelimi u redaktua ne kater kopje,nje kopje dorezohet ne Gjykatën e Rrethit Tirane ,nje kopje tjeter lihet ne Zyren Noteriale,kopja e trete dorezohet ne Degen e Tatimeve dhe kopja e katert do te mbahet nga une themeluesi i kesaj shoqerie se bashku me aktet e tjera.

Akti i themelimit neneshkruhet nga une rregullisht , themeluesi i kesaj shoqerie.

**Ortaku i Vetem
Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
ELKRI COMIMPEKS SHPK**

Fotina RONDO

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA SARANDE**



Nr.06 Rep.
Nr.1 8/2 Kol.

Sot me daten 01.02.2006 u paraqit para meje noterit Thoma Kaci , ne Zyren e Noterise Sarande , shtetasi Fotina Rondo , e bija e Lefterit , datelindja 1958 , lindur ne Himare-Vlore dhe banuese ne Sarande , ortak i vetem dhe administrator i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **ELKRI COMIMPEKS SHPK** , me seli ne qytetin e Sarandes , madhore , e afte dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin e se ciles u sigurova nga leternjoftimi i saj personal , e cila deklaroi sa me siper eshte shkruar , me vullnetin e saj te lire dhe i neneshkruar para meje.

Une mbasi e gjeta ne rregull e vertetoje sipas ligjit.

**NOTERI
Thoma KACI**

STATUTI **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

ELKRI COMIMPEKS SHPK

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 dhe te Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare", une e quajtura Fotina Rondo , e bija e Lefterit , datelindja 1958 , lindur ne Himare-Vlore dhe banuese ne Sarande, si themeluese e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **ELKRI COMIMPEKS SHPK**, sot me daten **01.02.2006** , duke pasur edhe zotesine juridike per te vepruar shpall per sa vijon:

Formohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar **ELKRI COMIMPEKS SHPK** , me themelues Ortakun e Vetem **Fotina Rondo** me Seli ne Sarande.

FORMIMI **NENI I**

Formohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar **ELKRI COMIMPEKS SHPK** , me themelues **Fotina Rondo**,e bija e Lefterit , e datelindjes 11.11.1958 , lindur ne Himare-Vlore dhe banues ne Lagjen Nr.4 Sarande.

QENDRA (SELIA) E SHOQERISE **NENI 2**

Qendra e Shoqerise do te jete fillimisht ne Lagjen Nr.4 Sarande , por me kalimin e kohes selia mund te ndryshoje si brenda dhe jashte rrethit me pelqimin e ortakut te vetem.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE **NENI 3**

Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj 35 vjet , te njepasnjeshme , por edhe mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cdo shkak nga ortaku i vetem.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE **NENI 4**

Veprimtaria e shoqerise do te konsistoje ne ushtrimin e aktivitetit privat ne :

- import eksport i pergjithshem ;
- tregeti me shumeice dhe pakice i te gjitha llojeve te prodhimeve , artikujve industriale , ushqimore , veshmbathje , bujqesore , blegtorale , te peshkimit detar e lumor, te materialeve te nderlidhjes , te llokacionit , te prodhimeve te ndertimit ;
- turizem ;
- shitblerje me shumeice dhe pakice te karburanteve dhe lubrifikanteve;
- te shitblerjes se trojeve dhe objekteve te ndertimit ;
- te veprimeve e transaksioneve financiare , zyres komisionere dhe veprime te tjera financiare me qellim biznesi .



KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali i shoqerise ne fillim do te jete 100.000 leke , kontribut i vete themeluesit te shoqerise.

Kapitali i kesaj shoqerie me pergjegjesi te kufizuar do te shtohet ose do te pakesohet me kalimin e kohes sipas vendimeve qe do te marre pronari i saj.

NENI 6

Kapitali themeltar i ortakut te vetem eshte lirisht i transferueshem edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve si dhe ne rruge trashgimie.

Gjithashtu jane lirisht te transferueshme ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardheseve dhe paraardhesve.

Me vullnetin e ortakut kapitali themeltar mund tu transferohet edhe personave te trete.

Ne rast vdekje te ortakut te vetem te shoqerise trashgimtarit e tij mund te vendosin per likuidimin e shumes se kapitalit themeltar ose per vazhdimin e veprimtarise duke respektuar rregullat e nenit 46 te ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

ASAMBLEJA

NENI 7

Ortaku i vetem ushtron gjithe kempetencat qe Ligji Nr.7638 date 19.11.1992 i ka dhene Asamblese se Ortakeve.

Vendimet e ortakut te vetem jane te detyrueshme per administratorin dhe personelin e shoqerise, kur keto jane marre konform ligjit dhe statusit.

NENI 8

Ortaku i vetem ka te drejte :

- Te emeroje dhe shkarkoje administratorin.
- Te informohet ne cdo kohe per veprimtarine e shoqerise dhe njihet me llogarine dhe dokumentacionin e saj.
- Te vendos per kryerjen e kontrolli revizionit financiar te shoqerise me ekspert te vendosur prej tij.
- Te jap aprovim financiar per cdo veprim financiar qe mund te kryhet nga administratori ne vleren mbi 500.000 leke.
- Te drejta te tjera qe parashikohen nga ligji "Per Shoqerite Tregtare".

ADMINISTRIMI

NENI 9

Shoqeria do te administrohet nga ortakut i vetem Fotina Rondo. Me kalimin e kohes mund te caktohet nje administrator tjetër me pelqimin e ortakut te vetem me nje afat deri ne dy vjet, por me te drejte rizgjedhjeje.

NENI 10

Administratori ka te drejte:

- te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha marredheniet e saj juridike dhe administrative brenda kompetencave te tij.



- 
- Te kryej cdo veprim qe e gjykon te arsyeshem dhe konform ligjit.
 - te jap urdhra dhe udhezime personelit te shoqerise dhe te vendos sanksione ndaj atyre ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe kontratat e punes.
 - Te angazhoje shoqerine ne marredhenie me te trette nepermjet veprimeve qe jane ne perputhje me objektin dhe strategjine e shoqerise.
 - Te pranoje dhe te largoje nga puna brenda shoqerise punemarres ne perputhje me dispozitat ne fuqi, brenda nevojave dhe organikes se percaktuar.

NENI 11

Administratori ka per detyre:

- Te punoje e te organizoje ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomike – financiare.
- Te zbatoje vendimet e marra nga ortakut i vetem dhe urdhrat e tij te dhena brenda kompetencave te percaktuara nga statute i legjislacionit ne fuqi.
- Te paraqese ne menyre te rregullt raportin e administrimit, inventarin e bilancin dhe llogarite vjetore ortakut te vetem brenda nje afati prej gjashte muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.
- Te pergjigjet ndaj shoqerise dhe ndaj te tretteve per shkeljet ligjore , per shkeljet e statutit te shoqerise si dhe per fajet kryera gjate administrimit.
- Te drejta dhe detyrime te tjera te percaktuara nga ligji per shoqerite tregtare.

NENI 12

Per perfaqesimin e shoqerise perpara organeve administrative, gjyqesore ose te tretteve duhet firma e administratorit.

NENI 13

Ne resta pengesash si semundje, aksidente, udhetime te administratorit e tjera ortakut i vetem ka te drejtene zvendesimit te perkohshem te tij.

NENI 14

Vula e shoqerise ka forme te rrumbullaket net e cilen eshte shkruar: **ELKRI COMIMPEKS SHPK** (shqip) dhe **ELKRI COMIMPEKS LTD** (anglisht).

NENI 15

Shoqeria vepron ne regjim te punes dhe merr persiper te drejta dhe detyrime. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore brenda kapitalit te saj te fituar.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 16

Veprimet mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti, pervec urdhrave te vecanta qe jep pronari per kete qellim. Administratori nxjerr bilancin me te ardhurat , fitimet , humbjet te formuluar konform ligjit.

NENI 17

Eshte kompetence e ortakut te vetem te vendos per krijimin e fondeve nga te ardhurat neto si dhe perdorimin e tyre.



SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 18

Duke qene se ne cdo kohe dhe per motive te ndryshme shoqeria mund te ndodhet perballe shperberjes,ortaku i vetem mund te vendos per menyren e likuidimit te saj ne baze te ligjeve ne fuqi. Ai vendos per likujdimin e nje ose me shume likuidatoreve duke u percaktuar edhe detyrat.

NENI 19

Shoqeria private ka numurin e llogarise rrjedhese te regjistruar ne Banken e Shtetit Shqiptar ne Sarande dhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 20

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut vlejne dispozitat e Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare",si dhe aktet e tjera ligjore qe rregullojne kete veprimtari.

NENI 21

Ky statut eshte hartuar ne kater ekzemplare ne Sarande :

- nje kopje dorezohet ne Gjykatën e Rrethit Tirane ku behet dhe regjistrimi,
- nje kopje tjeter lihet ne Zyren Noteriale Sarande ,
- nje kopje dorezohet ne Degen e Tatimeve Sarande,
- nje kopje do te mbahet nga une pronari e themeluesi i kesaj shoqerie se bashku me aktet e tjera.

Ortaku i Vetem

**Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
ELKRI COMIMPEKS SHPK**

Fotina RONDO



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA SARANDE**

Nr.506 Rep.
Nr.189/Kol.

VERTETIM

Sot me data 01.02.2006 u paraqit para meje noterit Thoma Kaci,ne Zyren e Noterise Sarande,shtetasi Fotina Rondo,i biri i Lefterit , datelindja 1958 , lindur ne Himare-Vlore dhe banues ne Sarande , ortak i vetem dhe administrator i Shoqerise **ELKRI COMIMPEKS SHPK** , me seli ne qytetin e Sarandes , madhore e afte dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi i saj personal , i cili deklaroi se sa me siper eshte shkruar me vullnetin e tij te lire dhe i neneshkuar para meje.

Une mbasi e gjeta ne rregull e vertetoje sipas ligjit.

**NOTERI
Thoma KACI**